



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA PRRENJAS

Nr. ____prot.

Prrenjas, më 17.08.2018

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Operatorin ekonomik: “SHAMO-CONSTRUCTION”, shpk, me nr.NIPT L01326020F me administrator z. Bardhi Shamo me seli në Tirane Njesia Bashkiake nr.5, Bulevardi Bajram Curri, Godina 8/1, Kati 10, Ap. 37, mbrapa pallateve Agimi.

Procedura e prokurimit: Kërkesë për propozim- punë.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-79718-07-18-2018

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Lyerje, merimetime, dizifektim per shkollat, kopshtet, çerdhen dhe godinat e institucioneve vartëse të Bashkisë”

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.29 datë 23 korrik 2018.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme d

Fondi limit: 3.750.000 (tre milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa tvsh.

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. BOE “Eni” sh.p.k dhe “Zdravo” sh.p.k, perkatesisht “Eni” sh.p.k me administrator Z.File Ahmatos, me nipt J94808408R, me adrese: Fier Lushnje, Lagjja Skender Libohova, Rruga Lutfi Bano, vile private dhe “Zdravo”shpk me administrator Z.Dashnor Sinanaj, me Nipt J84003411K, me adrese Fier Lushnje, Lagjja Xhevdet Nepravishta, Ish godina e plastmasit dhe me vlere te ofertes ekonomike 2,834,866 (dy milion e teteqind e tridhjetë e kater mije e teteqind e gjashtedhjetë e gjashte) leke pa tvsh dhe 3,401,839 (tre milion e katerqind e nje mije e teteqind e tridhjetë e nente) leke me tvsh.

2. “Sark” sh.p.k me administrator Z.Arben Kajolli, me nipt K52531415H, me adrese Fier lagjja “8 Shkurti” dhe me vlere te ofertes ekonomike 2,946,550 (dy milion e nëntëqind e dyzetë e gjashtë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh dhe 3,535,860 (tre milion e peseqind e tridhjetë e pese mije e teteqind e gjashtedhjetë) leke me tvsh.

3. “Shamo Constuction” sh.p.k, me nr.NIPT L01326020F, me administrator z. Bardhi Shamo me seli në Tirane Njesia Bashkiake nr.5, Bulevardi Bajram Curri, Godina 8/1, Kati 10, Ap. 37, mbrapa pallateve Agimi dhe me vlere te ofertës ekonomike 3,162,915 (tre milion e njeqind e gjashtedhjetë e dy mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë) leke pa tvsh dhe 3,795,498 (tre milion e shtateqind e nentedhjetë e pese mije e katerqind e nentedhjet e tete) leke me tvsh.

4. “Nika” sh.p.k me nipt J76705047U, me administrator Znj. Shpresa Nika, me adresë Shkodër Lagjja Vasil Shanto, Bulevardi Skenderbeu, godine 8-kateshe, kati i 1-re, zona kadastrale 8593, nr.pasurie 5/587 dhe me vlere te ofertës ekonomike 3,167,232 (tre milion e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e tridhjetë e dy) lekë pa tvsh 3,800,678 (tre milion e teteqind mije e gjashteqind e shtatedhjetë e tete) leke me tvsh.

5. BOE "Al-Dok" shpk dhe "Simaku" shpk, perkatesisht **"Al-Dok" shpk** me nipt J64103601Q, me administrator Z. Ajas Dookollari, me adrese Korçe-Udenisht, Komuna Udenisht, Qafë-Thanë, prane hotel Odesa, **"Simaku" shpk** me nipt K43721001Q, me administrator z.Thoma Simaku, me adrese Korçe Libonik SYMIZ Km. i 13, Rruga Korçe-Tirane, zona kadastrale 3553, nr.pasurie 723/10, me vlere te ofertes ekonomike 3,430,886 (tre milion e katërqind e tridhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh dhe 4,117,063 (kater milion e njeqind e shtatembdhjete mije e gjashtedhjetete e tre) leke me tvsh.

6. "Loshi BL" sh.p.k me nipt J67902618M, me administrator Z. Barjam Loshi, me adrese Elbasan Qukes Lagjja nr 1, Rruga Nacionale, banese private nr. pasurie 509, zona kadastrale 3120 me vlere te ofertës ekonomike 3,463,598 (tre milion e katërqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë pa tvsh dhe 4,156,317 (kater milion e njeqind e pesedhjetete e gjashte mije e treqind e shtatembdhjete) leke me tvsh.

7. "Colombo" sh.p.k me nipt J82916489E, me administrator Znj.Diana Laba, me adrese Fier Lagjja Kryengritja e Fierit, rruga Vangjel Rrushku, godina nr.67 me vlere te ofertës ekonomike 3,518,354 (tre milion e pesëqind e tetëmbëdhjetë mijë e treqind e pesëdhjetë e katër) lekë pa tvsh dhe 4,222,024 (kater milion e dyqind e njezete e dy mije e njezete e kater) leke me tvsh.

8. "Elda VL" sh.p.k me nipt K67106202W, me administrator Z.Artan Hoxhaj, me adrese Vlore L. H. CAKERRI 88 nuk ka paraqitur formular oferte ekonomike.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Bashkimi i operatoreve ekonomike "Eni" sh.p.k dhe "Zdravo" sh.p.k perkatesisht per arsyet e mëposhtme:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik në sistemin elektronik të APP-së, u konstatua se:

- Nuk i plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim.
- I plotëson kriteret e vecanta te Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar për kualifikim, të përcaktuara në DT.
- Nuk i plotëson kapacitetet teknike për kualifikim.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se **oferta nuk përmban** të gjithë dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit, referuar listës së Dokumentave Standarde të tenderit.

BOE ka paraqitur Akt-Bashkëpunimi për Bashkim të Përkohshëm të Operatoreve me nr.rep 1135 dhe me nr.kol 484 e datës 27.07.2018 e lidhur midis "Eni" shpk dhe "Zdravo" sh.p.k.

Nisur nga kerkesat e Nenit 74/2: *Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi*" dhe 74/1 te VKM-se nr.914, date 29.12.2014 *"Per miratimin e rregullave te prokurimit publik": Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi,"* nga shqyrtimi i kesaj kontrate bashkepunimi dhe ne formular oferten te dorezuar konstatohet se nuk jane percaktuar konkretisht se cilat zëra të preventivit te percaktuar ne dokumentat e tenderit merr persiper secili prej anetareve te bashkimit te shoqerive.

Persa me siper, mbeshtetur ne kerkesat e nenit 74/1 dhe 74/2, te VKM-se nr.914, date 29.12.2014, "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", kontrata e bashkepunimit nr.1032 rep, dhe nr.291 kol, date 27.03.2017 e bashkimit te shoqerive "Eni" shpk dhe "Zdravo" sh.p.k. dhe formulari i ofertes nuk ka percaktuar zërat e preventivit konkret qe merr persiper secili prej anetareve te bashkimit te shoqerive, e per rrjedhim nese ky bashkim operatoresh ekonomike do te ishte fitues potencial i kesaj procedure prokurimi, do te sillte pamundesi lidhje kontrata lidhur me reflektimin e pasqyres se kryerjes se puneve konkrete qe merr persiper secili prej anetareve te bashkimit te operatoreve ekonomike sipas preventivit ne dokumentat e tenderit.

2. Lidhur me kriterin e vecante te vedosur ne DST ne faqen 22 të saj, përkatësisht:

Pika **2.3.3** "Të kenë në pronësi ose me qera mjetet :

1	Kamionçine 3-5 tone	cope	1
2	Depozite uji 5000 litra	cope	1
3	Pompe suvatimi	cope	1
4	Motobetoniere	cope	1
5	Pompe per lyerje	cope	3
6	Skeleri	m ²	500

BOE nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që të vërtetojë pronësinë ose marrjen me qera/ të drejtën e përdorimit të 3 Pompave për lyerje të kërkuara në DST. Duke qënë se këto mjete janë shumë të rëndësishme për kryerjen dhe realizimin e objektit të tenderit, mosparaqitja e tyre nga BOE sjell mosplotësimin e këtij kriteri të vecante teknik të vendosur në dokumentat e tenderit.

Per sa me siper thekosjme se ne fund te Shtojces 11 Kriteret per Kualifikim, gjejme te percaktuar se: *Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.*

Referuar pikës 3 të nenit 53 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar gjejmë të percaktuar se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e percaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.*

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me nenin 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik **“Eni” sh.p.k dhe “Zdravo” sh.p.k nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit duke e cilësuar si ofertë të pavlefshme.**

2.Operatori ekonomik “Sark” sh.p.k perkatesisht per arsyet e meposhtme:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se:

- I plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim.
- I plotëson kriteret e vecanta të Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar për kualifikim, të percaktuara në DT.
- Nuk i plotëson kapacitetet teknike për kualifikim.
- Ka dorezuar formular oferte me gabime në preventiv.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se **oferta nuk përmban** të gjithë dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit, referuar listës së kërkesave të tenderit.

Operatori ekonomik “Sark” sh.p.k ka paraqitur shtojcën 1 “Formulari i ofertës”, i cili përmban zërat e punimeve sipas seksioneve përkatëse të preventivit, të plotësuar me treguesit e numrit të analizës, përshkrimin të punëve, njësisë, sasisë, cmimit për njësi dhe cmimit në total.

KVO-ja mori në shqyrtim formularin e ofertës me zërat e preventivit të plotësuar nga ofertuesi dhe konstatoi se në Zërin e punimeve: **“Shkolla Rashtan “Suvatim muri me krahe llac i perziere M25 me nr analize 2.312** rezulton se nga ana e këtij të fundit përlloraritjet janë bërë për sasinë 501 m², nga 50 të kërkuara nga autoriteti kontraktor, duke shtuar sasinë në zërin **“Suvatim muri me krahe llac i perziere M25 me nr analize 2.312,**sasi e cila është parashikuar më e ulët në preventivin e hedhur në sistemin elektronik të prokurimeve si pjesë e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit .

Gabimi në preventiv është bërë tek: "**Emertimi i punimeve: Shkolla Rashtan "Suvatim muri me krahe llac i perziere M25 me nr analize 2.312"** tek sasia kemi kërkuar 50 m2 ndërkohë operatori ekonomik ka paraqitur preventivin me sasinë **501**. Llogaritja për këtë zë punimi është bërë bazuar në këtë sasi, pra për 501 m2. Nga ky gabim në sasi në preventiv rezulton një ofertë më e lartë.

Në nenin 51, pika 1 dhe 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: "*1. Pas paraqitjes së ofertës nuk duhet të kryhet asnjë bisedim ndërmjet autoritetit kontraktor dhe ofertuesit për ofertën, në përputhje me pikën 1 të nenit 53 të këtij ligji.*

2. Një ofertuesi, si kusht për shpalljen fitues, nuk duhet t'i kërkohej që të ndërmarrë përgjegjësi të papërcaktuara në dokumentet e tenderit, të ndryshojë vlerën e ofertës së tij ose të modifikojë në çfarëdo mënyre ofertën."

Në nenin 53, pika 1 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, parashikohet se: "*Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 dhe 33 të këtij ligji, nuk duhet të kërkohej, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.*"

Ndërsa në pikën 3, të dispozitës së mësipërme thuhet shprehimisht:

"*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...*";

III.1.6. Sipas Seksionin 1 të Dokumentave Standarde të Tenderit "*Hartimi i ofertës*":

"*Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme.*" **(Ref. Vendimit te KPP nr. 44/2017)**

Në një situatë të tillë KVO-ja i qëndron mendimit se ndryshimi dhe shtimi i sasisë së një zëri në preventiv ndryshon kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit dhe për këtë arsye nuk mund të lejohet korrigjimi i ofertës pasi nuk jemi në rastin e gabimit aritmetik dhe të mospërputhjes së cmimeve gjatë përlogaritjes së ofertës ekonomike, sic parashikohet në rregullat e prokurimit publik si më sipërcituar. **(Ref. Vendimit te KPP nr. 44/2017)**

KVO gjykon se, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 2 i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar. Me marrjen pjesë në procedurën e prokurimit, operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. **(Ref. Vendimit te KPP nr. 44/2017)**

KVO-ja gjykon se bazuar në parimet e transparencës barazisë, dhe mosdiskriminimit operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion të barabartë, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur vlerësohen ato. Në rastin konkret KVO-ja konstaton se operatori ekonomik ka ndryshuar sasinë në njërin zë të preventivit të kërkuar nga autoriteti kontraktor, pasi ka shtuar sasinë. Në këto kushte neni 51 i ligjit të prokurimit publik si më sipër cituar, nuk e lejon autoritetin kontraktor të ndryshojë vlerën e ofertës së operatorit ekonomik "*Sark*" sh.p.k ose të modifikojë ofertën e tij, duke i hequr sasinë në zërin e punimeve në preventiv nga ky subjekt. Gjithashtu sic parashikohet në nenin 53, pika 1 të këtij ligji, nga ana e autoritetit kontraktor nuk mund të lejohet ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme. **(Ref. Vendimit te KPP nr. 44/2017)**

2. Operatori ekonomik ka paraqitur kontratën me nr.488 prot date 19.06.2017, kontratë e lidhur për marrjen me qera të një kamioni. Kjo kontratë është e lidhur midis palëve (pronarit te kamioncines dhe perfaqesuesit te "Sark" shpk) dhe nuk është lidhur para një noteri.

Ndërkohë që në DST ne pikën 2.3.3 të Kapacitetit Teknik është kërkuar:

2.3.3 Për mjetet ne pronesi qe shenohen ne regjistrat publike, duhet te paraqiten dokumentat qe vertetojne

rregjistrimin e mjetit si :- **Leje Qarkullimi, Siguracioni i mjetit dhe Çertifikatë e Kontrollit Teknik.** Për Pajisjet teknike ne pronesi te paraqiten faturat tatimore te shitjes ose deklaraten e zhdogadimit. Për mjete apo pajisjet teknike te marra me qera dokumentave te mesiperm ti bashkalidhen kontrata perkatese te qerese/ leasing / huaperdorjes, në emër të objektit, **të jenë të lidhura para noterit dhe afati i të cilave të përfshijë periudhën e shërbimit të objektit.**

Kontrata e paraqitur nuk është lidhur para noterit dhe nuk plotëson një nga kushtet e vendosura ne piken 2.3.3 te Kapacitetit Teknik.

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 “ Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” kreu VII, **neni 66, pika 3:** “Pas mbylljes se seances publike, komisioni i vleresimit te ofertave verifikon dhe vlereson ofertat e dorezuara, duke kualifikur vetem ato oferta qe permbushin kriteret per kualifikim, te percaktuara ne dokumentat e tenderit”, Komisioni konstatoi se ofertat nuk janë paraqitur ne perputhje me kerkesat e dokumentave standarte te tenderit. Nga shqyrtimi i këtyre ofertave në mbështetje me **Nenin 66/3** të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, u konstataua se keto oferta te operatorit ekonomik “Sark” **shpk nuk është në përputhje** me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar **si ofertë të pavlefshme.**

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 “ Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” kreu VII, **neni 66, pika 3:** “Pas mbylljes se seances publike, komisioni i vleresimit te ofertave verifikon dhe vlereson ofertat e dorezuara, duke kualifikur vetem ato oferta qe permbushin kriteret per kualifikim, te percaktuara ne dokumentat e tenderit”, si dhe referuar DST “Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.”

Komisioni konstatoi se ofertat nuk janë paraqitur ne perputhje me kerkesat e dokumentave standarte te tenderit. Nga shqyrtimi i këtyre ofertave në mbështetje me **Nenin 66/3** të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, u konstataua se keto oferta e operatorit ekonomik “SARK” **sh.p.k. nuk është në përputhje** me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar **si oferte të pavlefshme.**

3. BOE “Aldok” shpk dhe “Simaku” sh.p.k perkatesisht per arsyet e meposhtme:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstataua se:

- I plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim.
- I plotëson kriteret e vecanta te Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar për kualifikim, të përcaktuara në DT.
- Nuk i plotëson kapacitetet teknike për kualifikim.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga BOE vërehet se nga Formularët e Sig. te dorezuar ne sistem rezulton se dy operatoret kane te siguruar punonjes si më poshtë:

I.1 Muaji	I.2 Aldok (nr.punonjesish)	I.3 Simaku (nr.punonjesish)	I.4 Totali (nr.punonjesish)
I.5 Janar 2018	I.6 14	I.7 15	I.8 29
I.9 Shkurt 2018	I.1014	I.11 15	I.1229
I.13 Mars 2018	I.1414	I.15 15	I.1629
I.17 Prill 2018	I.1818	I.19 17	I.2035
I.21 Maj 2018	I.2217	I.23 17	I.2434
I.25 Qershor 2018	I.2616	I.27 16	I.2832

Në DST në Kriteret e vecanta per Kapacitetin Teknik është kërkuar: “2.3.3 Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; -Të kenë fuqi punëtore të siguruar mesatarisht jo më pak se 34 punonjës për periudhën (Janar – Qershor 2018) të vërtetuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve.”

Nga interpretimi i kriterit të mësipërm duhet që operatori ekonomik të ketë të punësuar gjatë periudhës 6 mujore

nje numer mesatar prej 34 punonjësish.

Pasi mbledhim totalin e punonjësve të të dy operatorëve për 6 muajt e kërkuar kemi:

$29+29+29+35+34+32=188$ punonjës

Pjestojmë shumën me 6 (gjashtë muajt e kërkuar); $188:6=31,33$ punonjës

Mesatarja e punonjësve të BOE "Aldok" shpk dhe "Simaku" shpk për 6 muajt e kërkuar është **31,33** nga **34** punonjës të kërkuar në DST.

Referuar kriterit të vendosur në DST, BOE nuk e plotëson këtë kriter pasi nuk ka kapacitetin njerezor të duhur për plotësimin dhe realizimin e objektit të kontratës.

2. BOE ka paraqitur Kontrate marreveshje shoqërie të datës 28.07.2018 për Bashkim të Përkohshëm të Operatorëve e lidhur midis "Al-dok" shpk dhe "Simaku" sh.p.k.

Bashkimi është krijuar me një marrëveshje të noterizuar, ku janë përcaktuar përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Bazuar në nenin 74/1 të VKM-se nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik": Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi," nga shqyrtimi i kësaj oferte konstatohet se nuk janë përcaktuar se cilat zëra të preventivit të përcaktuar në dokumentat e tenderit merr persiper secili prej anetareve të bashkimit të shoqërive.

Per sa me sipër thekosjme se në fund të Shtojcës 11 Kriteret për Kualifikim, gjejmë të përcaktuar se: ***Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim."***

Referuar pikës 3 të nenit 53 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar gjejmë të përcaktuar se: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me Nenin 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin publik" i ndryshuar si dhe Dokumentave Standarde të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e operatorit ekonomik BOE "Aldok" shpk dhe "Simaku" shpk nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar **si ofertë të pavlefshme.**

4. Operatori ekonomik "Loshi BL" shpk perketesisht për arsyet e meposhtme:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se:

- I plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim.
- I plotëson kriteret e vecanta të Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar për kualifikim, të përcaktuara në DT.
- Nuk i plotëson kapacitetet teknike për kualifikim.
- I përmbush specifikimet teknike të paraqitura në DST.

Operatori ekonomik ka paraqitur vertetimin "Për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Tatimpaguesin - E-SIG 02/a" me Nr. T00459069 Datë, 28.07.2018 nga i cili rezulton se OE ka 958 lekë detyrime.

OE nuk ka paraqitur formularet e sigurimeve për 6 muajt nepermjet se cilit të vertetonte se ka 34 punonjës të siguruar.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se **oferta nuk përmban** të gjithë dokumentacionin e kërkuar në

dokumentet e tenderit, referuar listës së kërkesave të tenderit, në mbështetje të pikës 3 të nenit 66 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 “ Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me **Nenin 53** të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” i ndryshuar si dhe Dokumentave Standarde të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e operatorit ekonomik **“Loshi BI” shpk nuk është në përputhje** me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar **si ofertë të pavlefshme**.

5. Operatori ekonomik “Elda VL” sh.p.k perkatesisht per arsyet e meposhtme:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se:

- Nuk i plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim.
- Nuk i plotëson kriteret e vecanta të Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar për kualifikim, të përcaktuara në DT.
- Nuk i plotëson kapacitetet teknike për kualifikim.
- Nuk i përmbush specifikimet teknike të paraqitura në DST.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se **oferta nuk përmban** të gjithë dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit, referuar listës së kërkesave të tenderit, në mbështetje të pikës 3 të nenit 66 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 “ Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 66 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 “ Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Operatori ekonomik “Elda VI” shpk ka paraqitur formular oferte ekonomike bosh.

Ka paraqitur vetëm ekstraktin historik dhe ekstraktin e thjeshtë të QKR, duke mos plotësuar kështu asnjë nga kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me Nenin 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” i ndryshuar si dhe Dokumentave Standarde të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e operatorit ekonomik **“Elda” shpk nuk është në përputhje** me asnjë nga kërkesat e tenderit, duke e cilesuar **si ofertë të pavlefshme**.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik **“Shamo Constuction” sh.p.k**, me nr.NIPT L01326020F, me administrator z. Bardhi Shamo me seli në Tirane Njesia Bashkiake nr.5, Bulevardi Bajram Curri, Godina 8/1, Kati 10, Ap. 37, mbrapa pallateve Agimi dhe me vlere të ofertës ekonomike 3,162,915 (tre milion e njeqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë) leke pa tvsh dhe 3,795,498 (tre milion e shtateqind e nentëdhjetë e pese mijë e katerqind e nentëdhjetë e tete) leke me tvsh se oferta e paraqitur prej tij është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Prrrenjas sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlere përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **09.08.2018**

Ankesa: Nuk ka ankesa

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
KRYETARI
MIRANDA RIRA